# S T A T U T I

## I SHPK"BIRRA KORÇA"

"Birra Korça" SH P K u krijua si e tillë duke pasur si bazë Ndërmarrjen shtetërore "Birra Korça" e cila ju shit ortakëve që themeluan këtë shoqëri.Qëllimi i shoqërisë është prodhimi,tregëtimi,brenda dhe jashtë shtetit i birrës,pijeve alkoolike dhe freskuese,ujrave minerale si dhe krijimi i aktiviteteve të ndryshme shërbimi dhe turizmi.Birra Korça SH P K është shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar,pra sejcili nga anëtarët përballon humbjet deri në masën e kontributit fillestar të pranuar si mesatare.

**Neni 1**

Fabrika e Birrës Korçë SH P K që do taquajmë shkurt F.B.K. është person juridik dhe fillon veprimtarinë e saj fill mbas rregjistrimit të saj në organet kompetente.F.B.K. do të veprojë konform legjislacionit të Republikës së Shqopërisë si dhe konform aktit themelues të saj dhe këtij statuti,që përbën aneksin "A" të këtij akti.

**Neni 2**

Vendndodhja e F.B.K(SH.P.K.) është në territorin e fabrikës së birrës Korçë.Në përputhjë me legjislacionin në fuqi ajo ka të drejtë në të ardhmen të hapë filiale dhe angjensi tregëtimi kudo,si brenda teritorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.

**Neni 3**

F.B.K.plotëson nevojat e veta me fondet e saj dhe kur këto nuk janë të mjaftueshme,plotësohen me kredi nga bangat shqiptare apo të huaja si dhe nga kapitalet shtesë të ortakëve të saj.Aktiviteti i F.B.K-së parashikohet për 50 vjet

## TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE

**Neni 4**

Të drejtat dhe detyrat e ortakëve ushtrohen nëpërmjet vendimeve të mara në Asamblenë e ortakëve,në përputhjë me aktin Themelues,statutin

e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Çdo ortak ka të drejtë të vihet në dijeni për veprimtarinë e F.B.K si prodhimi, tregëtimi dokumentacioni, bilancet etj, duke ruajtur sekretin Kjo e drejtë i njihet për tre vjetet e fundit të aktivitetit të F.B.K

- 2 javë para asamblese së ortakëve te ngrerë probleme me shkrim.

- Çdo ortak ose grup ortakësh që përfaqëson jo më pak se 10 % të kapitalit mund të kërkojë mbledhjen e asamblesë por pa evituar rendin e ditës.

- Të marrë pjesë në mbledhje dhe të votojë lirisht.

- Të heqë dorë nga F.B.K duke lajmëruar për këtë të paktën 3 muaj përpara me shkrim, duke i ofruar së pari të drejtën e blerjes së aksioneve ortakëve të F.B.K-së dhe në se asnjë nga keta nuk pranon, mund t'ja shesë ato personave te tretë, po me çmim jo më të vogël se ai i propozuar ortakëve.

## Neni 5

## Detyrat kryesore të ortakëve janë:

- Të depozitojë kuotën e vet simbas sotimit para ortakërise, duke dokumentuar keta veprim në aktin përkatës.

- Të plotësojë detyrimet që burojnë nga akti themelues dhe statuti.

- Të japë kontributin maksimal për të bërë që veprimtaria e F.B.K të fillojë sa më parë.

- Të përfaqësohet vetë ose me përfaqësues të pajisur me prokurë dhe konform ligjeve në mbledhjet e Asamblesë.

## Neni 6

Pasi derdhen kuotat e sotuara për kapitalin themeltar si dhe të kapitaleve shtesë sejcili ortak pajiset me dokumentacion përkatës noterial ku vertetohet kontributi i tij në F.B/K. ,SH.P.K.

## Neni 7

Në rast se ndërpritet aktiviteti i F.B.K-së, pasi shlyhen gjithë detyrimet ndaj të tretëve, pjesa e mbetur ndahet midis ortakëve në përpjestim me aksionet që ka sejcili në momentin e shkrirjes së

shoqërisë.

**Neni 8**

F.B.K (SH.P.K.) ka të drejtë të blejë pasuri të tjera brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë,të lëshojë me:qira e të lerë peng pasurinë e saj,konform me legjislacionin në fuqi.

**Neni 9**

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme tek ortakët e tjerë,tek trashëgimtarët ligjorë apo bashkëshortët e tyre konform ligjeve.

Në të:gjitha rastet subjektet që trashëgojnë aksionet do të kenë detyrimet dhe të drejtat e ortakut paraardhës.

**Neni 10**

F.B.K(SH.P.K) mund ta zvogëlojë kapitalin me miratim të Asamblesë Themeluese,por me kusht që zvogëlimi të prekë në të njëjtën masë të gjithë ortakët.Projekti për zvogëlim kapitali duhet t'u komunikohet ortakëve 30 ditë para mbledhjes së Asamblesë.

**Neni 11.**

F.B.K krijon fonde rezervë konform ligjeve,pra 5 % e fitimit deri sa arin 10 % e kapitalit themelues për të përballuar veshtirësitë ekonomike që mund të lindin,dhe këto kur nuk mjaftojnë përballohen nga shtesat që mund të bëjnë ortakët.

**Neni 12**

Fitimi i F.BK.(SH.P.K),mbasi zbritet amortizimi,shpenzimet e prodhimit (kostua),tatimet,kreditë dhe pjesa e destinuar për investim ndahet midis ortakëve simbas dispozitave të aktit themelues.

**Neni 13**

Aktiviteti ekonomik i F.B.K-së pasqyrohet në bilance parciale financiare 3 mujore si dhe në bilancin e plotë vjetor,i cili duhet të dalë deri në 31 mars të vitit pasardhes.

**Neni 14**

Organi vendimar i F.B.K-së SH.P.K.është Asambleja e Ortakëve,

e cila drejtohet nga drejtori.

Asambleja mblidhet të paktën një herë në vit dhe vendos për problemet themelore të SH.P.K.:

1.Miratimin ose jo të bilanсit vjetordhe destinacionin e të ardhurave të bilancit.

2.Ndryshimin e statutit të shoqërisë.

3.Zmadhimin apo pakësimin e kapitalit themelor.

4.Miraton strukturën e administratës.

5.Miraton plan-bisneset vjetore dhe të perspektivës.

6.Mer vendime për bashkëpunim me shoqëri të tjera.

7.Miraton shndërimin e SH.P.K në një formë tjetër ose për mbylljen e shoqërisë,emërimin e likuidatorit dhe pagën e tij.

8.Miraton blerjen apo transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar tek trashëgimtarët,ortakët apo të tretët.

9.Vendos për emërimin ose shkarkimin e administratorëve dhe numrin paraprak të tyre,Zgjedh shefin kontabël e miraton pagën e tij

Asambleja mblidhet me njoftimin e drejtorit apo të zevendësit të tij Në njoftim duhet të tregohet rendi i ditës,vendi,data dhe ora e mbledhjes 15 ditë para ditës së mbledhjes.

Mbledhjet e Asamblesë janë të vlefshme dhe pa njoftimin paraprak kur janë present gjithë ortakët.Asambleja drejtohe nga drejtori i shoqërisë e në mungesë të tij të zevendësit të tij.Një sekretar që emërohet mund të jetë dhe një person që nuk është ortak.Në asambletë e jashtëzakonëshme rolin e sekrétarit duhet ta kryejë një ortak.

<u>Neni 15</u>

Administrata e P.B.K mundtë përbëhet nga një ose disa persona fizikë që mund të mos jenë ortakë.

Administratori (drejtori) kryen të:gjitha veprimet drejtuese, organizative,administrative dhe kontraktuese.Ai paraqitet në veprimtarinë civile si edhe para organeve gjyqësore dhe të pushtetit si palë në emër dhe për llogari të P.B.K (SH.P.K),për të mgjidhur mosmarrëveshjet

që mund të lindin gjatë veprimtarisë së F.B.K.

Administratori zgjidhet për një periudhë njëvjeçare nga Asambleja e ortakëve dhe mbas mbarimit të këtij afati, Asambleja vendos në se do të vazhdojë aktiviteti i tij apo do të zgjidhet një tjetër.

Administratori nuk vendos për problemet që janë në kompentcat e Asamblesë së Ortakëve.

Neni 16

Administratori është i detyruar të paraqitë për miratim para Asamblesë së Ortakëve të gjitha marrëveshjet e arritura duke paraqitur raport me shkrim. Në këtë rast administratori ortak nuk merr pjesë në votim. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja i ngarkohen administratorit që i përballon individualisht ato.

Neni 17

Administratori nuk lejohet të marrë hua nga shoqëria, të japë paradjënie hua, ose të bëhet dorëzënës për pasurinë e shoqërisë.

Për çdo kundravajtje ligjore të kryer nga administratori ose kontradiktë, ortakët kur nuk i zgjidhin dot ato nëpërmjet mbledhjeve të Asamblesë, mund të ngrenë padi gjyqësore sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 18

Për F.B.K. do të caktohet një ekspert kontabël i cili ka për detyrë të kontrollojë veprimtarinë ekonomiko-financiare dhe deklaron të metat e konstatuara gjatë kësaj veprimtarie.

Ai ka për detyrë:

a. Të kontrollojë respektimin e ligjeve, statutit, vendimeve të Asamblesë.

b. Të verifikojë mbajtjen e rregullt të kontabilitetit të shoqërisë si dhe të kontrollojë lidhjet e bilancit me llogarinë e fitimeve dhe humbjeve që rezultojnë në librin dhe dokumentet kontabël.

c. Të paktën çdo tremujor para mbylljes së bilancit, të sigurojë në bazë të inventarit të librave të shoqërisë, gjendjen e arkës, ekzistencën

dhe titujt e pasurisë.

Neni 19

Administratorët dhe shefi kontabël mbajnë përgjegjësi penale për çdo shkelje me ndërgjegje të detyrave të ngarkuara nga Asambleja e Ortakëve apo të statutit si dhe kur lenë pa kryer veprime të detyrueshme që i sjellin dëme materiale shoqërisë apo,kur me ndërgjegje paraqesin të dhëna fallco kontabile,etj.

Neni 20

Këtij statitu mund t'i bëhen vërejtje deri në momentin e miratimit të tij nga ortakët në mbledhjen e parë të tyre.Në këtë mbledhje emërohen dhe administratorët e shoqërisë.

Neni 21.

Në çdo mbledhje të Asamblesë mbahet procesverbal (nga një sekretar i shoqërisë)në një libër përkatës që ruhet për gjithë kohëzgjatjen e shoqërisë.Në fund të çdo mbledgjeje,procesverbali firmoset nga sekretari dhe nga administrtori i,shoqërisë.Në mbledhjet e jashtëzakonëshme të asamblesë procesverbali mbahet nga një sekretar ortak.

Neni 22.

Ky statut hyn në fuqi menjëherë mbas miratimit dhe nënshkrimit të ortakëve.Për çdo mungesë që do të reflektohet në të,problemet që mund të lindin në të ardhmen do të zgjidhen sipas legjislacionit në fuqi.

Asambleja në mbledhjen e saj të parë zgjodhi si drejtor zotin Franko Sare dhe Zv/drejtor zotin Koço Pojani,të punësuar si teknolog.

Statuti i firmosur mbyllet me numur 22 (njëzet e dy)

1.Minella Qeni
2.Gaqo Menkshi
3.Franko Sare
4.Remzo Veriga
5.Thanas Qeleshi
6.Miro Kote
7.Gjergji Asllani
8.Kajmak Bardollari
9.Vasil Pashko
10.Gjergji Pojani
11.Thana Beqka

Korçë,më 02.02.1994